VENDIM
Nr. 645, datë 3.8.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) DHE NDËRTESAVE PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSITË ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA "5 MAJI", DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE 6, ZONA "KOMBINAT", BASHKIA TIRANË

(Ndryshuar me vendimin nr. 1130, datë 24.12.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja "a", të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit nga Bashkia Tiranë, në masën 14 385 346 958 (katërmbëdhjetë miliardë e treqind e tetëdhjetë e pesë milionë e treqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesat publike, në zonat e reja për zhvillim në njësitë administrative 4 e 8, zona "5 Maji", dhe Njësinë Administrative 6, zona "Kombinat", Bashkia Tiranë.

2. Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë në masën 1 136 002 934 (një miliard e njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim në njësitë administrative 4 e 8, zona "5 Maji", dhe njësinë administrative 6, zona "Kombinat", Bashkia Tiranë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Fondet e mbetura të papërdorura pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin "Fondi për rindërtim" të buxhetit të shtetit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe